



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

[Shqip] Kërkesë për Shprehje të Interesit (Arkitekt / Arkitekte - 1 (një) pozitë)

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) shpall Kërkesë për Shprehje të Interesit për një (1) pozitë për Njësitin e Menaxhimit të Projektit (NjMP), në kuadër të Projektit “Banimi Social Adekuat” (PBSA) në Kosovë.

Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes Ministrisë së Financave, ka lidhur Marrëveshjen e Kredisë me **Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës (BZHKE / CEB)** për financimin e Projektit “Banimi Social Adekuat” në Kosovë.

Projekti i Banimit Social Adekuat (PBSA) synon të përmirësojë qasjen në banim adekuat për familjet dhe individët në nevojë, përmes rritjes së stokut të banimit social dhe përmirësimit të kushteve të banimit të familjeve përfituese. Projekti zbatohet përmes një qasjeje të koordinuar ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal, me përfshirjen aktive të komunave përfituese.

Në fazën aktuale të implementimit, Projekti mbështet **21 komuna të Republikës së Kosovës** në zhvillimin dhe zbatimin e nën-projekteve të Banimit Social Adekuat, të cilat përfshijnë, ndër të tjera, **ndërtimin e njërive të reja të banimit social dhe renovimin/rindërtimin e shtëpive private të familjeve përfituese**. Komunat janë në faza të ndryshme të përgatitjes së projekteve, revidimit, prokurimit dhe zbatimit.

MMPH është institucioni përgjegjës për zbatimin e Projektit, ndërsa në kuadër të tij funksionon **Njësi i Menaxhimit të Projektit (NjMP)**, i cili siguron koordinimin, menaxhimin, monitorimin dhe sigurimin e cilësisë së zbatimit të Projektit në nivel qendror.

NjMP bashkëpunon ngushtë me **Njësitë e Implementimit të Projektit (NjIP) në komuna**, me institucionet përkatëse të MMPH-së, si dhe me **Asistencën Teknike WBIF IPF-11** dhe ekspertët e angazhuar në mbështetje të Projektit.

NjMP përbëhet nga Udhëheqësi i Projektit, Arkitekt/e, Specialist/e Prokurimi, Specialist/e të Menaxhimit Financiar, Asistent/e Administrativ dhe Menaxher/e të TI-së.

Në këtë kuadër, NjMP kërkon të angazhojë një **Konsulent/e - Arkitekt/e**, i/e cili/a do të kontribuojë në menaxhimin teknik të nën-projekteve, rishikimin dhe sigurimin e cilësisë së dokumentacionit projektues, mbështetjen teknike të NjIP-ve dhe komunave, monitorimin e

gatishmërisë së projekteve për revidim dhe prokurim, si dhe në koordinimin e çështjeve teknike gjatë implementimit të Projektit.

Shprehja e interesit me letër përcjellëse, si dosje në një zarf me të gjitha dokumentet e kërkuara, mund të dorëzohet në adresën e mëposhtme nga data 02/09/2026 - 17/09/2026, dokumentet dorëzohen drejtpërdrejt në Divizionin për Burime Njerëzore të MMPH - Ndërtesa e ish Rilindjes Kati 16 Nr. Zyrës 1617 - Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 8:00 - 16:00 apo përmes postës fizike.

Më shumë informata për pozitën përkatëse mund të gjeni më poshtë:

1. Konsulent – Arkitekt / Arkitekte e Njësitit të Menaxhimit të Projektit (NjMP);

Bazuar në nenin 17 paragrafi 5 nenin 47 dhe nenin 48 të Ligji NR. 08/L-099 për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë shtetërore, pikës 5 të Marrëveshjes se Kredisë në mes të Republikës së Kosovës Përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin “Banimi Social Adekuat” e ratifikuar me Ligjin Nr. 08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes se Kredisë në mes të Republikës së Kosovës Përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin “Banimi Social Adekuat”, dhe dispozitave ligjore të Rregullores MF-NR. 05/2017 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores MF-NR. 01/2016 për Administrimin e fondeve të Huamarrjes, e Plotësuar dhe Ndryshuar me Rregulloren MF-NR 03/2017, shpall:

1. KONKURS (PËR VEND TË LIRË PUNE)

Titulli i punës: Konsulent – Arkitekt / Arkitekte e Njësitit të Menaxhimit të Projektit (NjMP) për banim Social Adekuat,

I raporton: Divizioni për Banim (DB), Drejtorit të Departamentit për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim (DPHNB), Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe përfaqësuesit të Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE).

Kohëzgjatja e emërimit: 1 vit

Niveli i pagës neto: 1.100 EURO,

Pozita e kërkuar: 1,

Afati kohor i aplikimit: 02/09/2026 - 17/09/2026, (15 ditë kalendarike),

Institucioni: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH),

Departamenti: Departamentit për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim (DPHNB),

Njësia: Njësi i Menaxhimit të Projektit (NjMP) – Projekti për Banim Social Adekuat (PBSA),

Vendi i punës: Prishtinë.

1. Vështrim i përgjithshëm i programit

Projekti i Banimit Social Adekuat (PBSA) synon krijimin dhe forcimin e një sistemi të qëndrueshëm të banimit social dhe të përballueshëm, duke përmirësuar qasjen në banim adekuat për familjet dhe individët në nevojë dhe duke rritur stokun e banesave të përshtatshme. Programi zbatohet përmes një sistemi të koordinuar ndërmjet nivelit qendror dhe komunave, ku NjMP koordinon zbatimin e përgjithshëm dhe NjIP-të mbështesin zbatimin në nivel lokal.

Programi përfshin, ndër të tjera, ndërtimin e njërive të reja të banimit social, si dhe renovimin/rindërtimin e shtëpive private të familjeve dhe individëve në nevojë. Zbatimi kërkon koordinim të vazhdueshëm ndërmjet MMPH/NjMP, komunave/NjIP-ve, projektuesve, reviduesve, operatorëve ekonomikë dhe Asistencës Teknike WBIF IPF-11.

Arkitekti/Arkitektja e NjMP-së është pjesë e kapacitetit teknik të NjMP-së dhe kontribuon në sigurimin e cilësisë, koherencës dhe gatishmërisë së dokumentacionit teknik, monitorimin e progresit të nën-projekteve dhe mbështetjen teknike të komunave.

2. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

NjMP kërkon të angazhojë një konsulent/e arkitekt/e për të ofruar mbështetje profesionale në menaxhimin teknik të nën-projekteve, rishikimin e dokumentacionit arkitektonik dhe teknik, koordinimin me NjIP-të, projektuesit dhe reviduesit, si dhe monitorimin e gatishmërisë së komunave për projektim, revidim, prokurim dhe zbatim.

Pozita nuk zëvendëson përgjegjësitë ligjore dhe kontraktuale të projektuesve, reviduesve, mbikëqyrësve profesionalë apo komunave. Roli është kryesisht teknik, koordinues, verifikues dhe këshillues në nivel të menaxhimit të projektit.

Objektivat kryesore të angazhimit të një konsulenti arkitekt/e brenda Njësitit të Menaxhimit të Projektit (NJMP) janë si më poshtë:

- Të mbështesë Udhëheqësin e NjMP-së në koordinimin teknik dhe monitorimin e nën-projekteve të PBSA-së.
- Të rishikojë projektet Ideore, Kryesore dhe dokumentacionin shoqërues, duke evidentuar mangësitë dhe mospërputhjet.
- Të kontrollojë përputhshmërinë me Detyrat Projektuese, kërkesat e PBSA-së, parametrat urbanistikë dhe standardet/rregulloret relevante.
- Të mbështesë procesin e revidimit: komentet, ndjekjen e adresimit dhe kontrollin e versioneve të ridorëzuara.
- Të mbështesë përgatitjen/kontrollin e TeR-ve, specifikimeve teknike dhe Listave të Çmimeve në pjesën arkitekturore.
- Të monitorojë gatishmërinë e komunave për projektim, revidim, prokurim dhe zbatim.
- Të ofrojë mbështetje për NjIP-të përmes takimeve, vizitave në terren, komenteve dhe udhëzimeve teknike.
- Të kontribuojë në identifikimin dhe menaxhimin e risqeve/pengesave teknike të komunave.
- Të bashkëpunojë me AT WBIF IPF-11 dhe ekspertët e saj për çështjet teknike dhe ngritjen e kapaciteteve.

- Të kontribuojë në standardizimin e dokumentacionit dhe praktikave të projektimit/zbatimit.

Fusha e veprimit të punës për konsulentin arkitekt/e do të përfshijë, por pa u kufizuar në sa vijon:

- Rishikimin e projekteve Ideore, Kryesore dhe dokumentacionit shoqërues të komunave/projektuesve.
- Kontrollin e programit funksional, tipologjive dhe sipërfaqeve të njësive të banimit, hapësirave të përbashkëta, qasjes, parkingjeve dhe hapësirave të jashtme.
- Kontrollin e konsistencës ndërmjet vizatimeve, përshkrimit teknik, pasqyrave të sipërfaqeve, specifikimeve dhe Listave të Çmimeve.
- Shqyrtimin e komenteve të reviduesve dhe monitorimin e adresimit të tyre.
- Kontrollin e kompletësisë së dosjeve para revidimit ose inicimit të prokurimit.
- Përgatitjen e komenteve teknike, kërkesave për sqarim dhe shkresave teknike për komunitat, projektuesit dhe reviduesit.
- Pjesëmarrjen në takime teknike dhe vizita në terren; këto nuk zëvendësojnë mbikëqyrjen profesionale të ndërtimit.
- Kontributin në Municipal Status Matrix, Risk Register dhe Master Design/Revision/Procurement Matrix.
- Mbështetjen në përgatitjen e materialeve për takime, misione, punëtori dhe raporte të NjMP-së.

Konsulenti (arkitekt / arkitekte) do të dorëzojë rezultatet kryesor (Outputet) e mëposhtme:

- Komente/raporte teknike për projektet e shqyrtuara.
- Matrica të përditësuara të statusit të projekteve, revidimeve dhe gatishmërisë teknike të komunave.
- Rekomandime dhe kërkesa për plotësim të dokumentacionit.
- Kontribut në kontrollin e dosjeve të tenderit dhe dokumenteve teknike të prokurimit.
- Raporte të shkurtra pas vizitave në terren dhe takimeve teknike.
- Kontribut në Risk Register dhe Master Design/Revision/Procurement Matrix.
- Kontribut në raportimin javor/mujor të NjMP-së.
- Kontribut në checklistat, modelet dhe dokumentet standarde për NjIP-të.
- Raport përfundimtar me aktivitetet, gjetjet dhe rekomandimet.

3. Kërkesat e përgjithshme për punësim

- Diplomë Master në Arkitekturë (M.Sc., M.Arch., M.A. ose ekuivalente) nga institucion i njohur dhe i akredituar; për diploma jashtë Kosovës kërkohet nostrifikimi sipas procedurës përkatëse.
- Përvojë profesionale së paku 5 vjet në projektim urb-arkitektural, zhvillim/rishikim projektesh dhe/ose menaxhim teknik.
- Përvojë e dëshmuar në projekte banimi; përvoja eventuale në banim social, apo projekte publike ose projekte të financuara ndërkombëtarisht përbën përparësi.

- Njohuri të mira të legjislacionit, kodeve, standardeve dhe rregulloreve relevante për projektimin dhe ndërtimin në Kosovë.
- Përvojë në koordinimin me ekupe multidisciplinare dhe bashkëpunimin me institucione publike, komuna, projektues dhe revidues.
- Aftësi të forta analitike për kontrollin e dokumentacionit teknik dhe identifikimin e mospërputhjeve.
- Aftësi të mira në AutoCAD/DWG dhe programe të tjera relevante; njohja e BIM përbën përparësi.
- Aftësi të forta komunikimi dhe ndërpersonale, me aftësi për të ndërlidhur në mënyrë efektive me palët e interesuara në nivele të ndryshme.
- Njohuri të avancuara të gjuhës angleze për dokumentacion teknik dhe komunikim me partnerët/ekspertët ndërkombëtarë.
- Gatishmëri për vizita dhe udhëtime në komunat përfituese.

4. Kërkesat e përgjithshme formale

- Të jetë shtetas/e i/e Republikës së Kosovës, sipas kërkesave të procedurës së angazhimit.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës.
- Të ketë njohuri të avancuara të gjuhës angleze.
- Të mos ketë konflikt interesi me detyrat e pozitës dhe të respektojë konfidencialitetin dhe integritetin profesional.
- Të jetë i/e gatshëm/e për angazhim dhe udhëtime sipas nevojave të NjMP-së.

5. Kërkesa të përgjithshme (Njohuri, Aftësi, Cilësi, Kompetenca)

- Profesionalizëm dhe integritet.
- Aftësi të larta analitike dhe organizative.
- Menaxhim i shumë detyrave dhe respektim i afateve.
- Gjykim profesional dhe vendimmarrje e argumentuar.
- Orientim në rezultate dhe zgjidhje praktike.
- Komunikim i qartë dhe punë ekipore.
- Aftësi për përgatitjen e raporteve, tabelave, matricave dhe dokumenteve teknike.
- Kujdes ndaj detajeve dhe kontroll i cilësisë.
- Aftësi për identifikimin në kohë të risqeve, vonesave dhe pengesave.
- Aftësi për të punuar në mjedis dinamik të menaxhimit të projektit.

6. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Letër motivimi.
- CV e përditësuar me përvojën relevante.
- Kopje e letërnjoftimit/pasaportës.
- Kopje e diplomës së kërkuar dhe dokumenti i nostrifikimit, kur aplikohet.
- Dëshmi për përvojën e punës, me pozitën dhe kohëzgjatjen.
- Portofol profesional, veçanërisht projekte banimi/projekte publike.

- Dëshmi për licencën profesionale në arkitekturë.
- Vërtetim nga gjykata për mosdënim, jo më i vjetër se gjashtë muaj.
- Dokumente të tjera mbështetëse për përvojë relevante në menaxhim/rishikim projektesh, prokurim ose projekte ndërkombëtare.

7. Kriteret e vlerësimit:

- Kandidatët që plotësojnë kushtet formale vlerësohen përmes një kombinimi të kualifikimeve/përvojës së dokumentuar dhe ftohen për t'iu nënshtruar intervistës profesionale me gojë, në përputhje me procedurën institucionale.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në projekte / njësite të projekteve përmes fondeve të huamarrjes në Kosovë, siç është specifikuar në Ligj. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia e nën përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë për pozitat e shpallura. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk do të pranohen dhe aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen.

Shprehja e interesit me letër përcjellëse, si dosje në një zarf të mbyllur me të gjitha dokumentet e kërkuara, mund të dorëzohet në adresën e mëposhtme nga data 02/09/2026 - 17/09/2026, dokumentet dorëzohen drejtpërdrejt në Divizionin për Burime Njerëzore të MMPH - Ndërtesa e ish Rilindjes Kati 16 Nr. Zyrës 1617 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 8:00 – 16:00 apo përmes postës fizike.